



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2021:223538

Datë: 30.01.2024

Numri i dokumentit: 05260790

C. nr. 986/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, me gjyqtarin Astrit Gashi me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Remzi Duli, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.H nga Gllogoci, të cilin e përfaqëson i autorizuari i tij sipas autorizimit H.H nga Gllogoci, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim i pagës, me vlerë të kontestit prej 541.55 €, jashtë seancës me datën 30.01.2024 e mori këtë:

A K T G J Y K I M PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit F.H nga Gllogoci, mësimdhënës në SHML “GJ.K. S...” në Gllogoc, dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim në Gllogoc që paditësit të ia kompensoj në emër të pagës së papaguar për muajin gusht 2021 në shumën prej **541.55 Euro**, si dhe shpenzimet e procedurës në shumën e përgjithshme prej **125 Euro**, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënimin e përmbarimit ligjor.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

I autorizuari i paditësi ka paraqitur padi me dt.06.10.2021, kundër te paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim, për kompensimin e pagës për muajin Gusht te vitit 2021 ne vlere prej 541.55 Euro, pasi qe paraprakisht i është refuzuar kërkesa për realizmin e pagës nga e paditura ne baze te aktvendimit me nr... i dt.07.09.2021, duke i propozuar gjykatës qe te aprovoj ne tersi padinë dhe kërkesë padinë e paditësit duke e obliguar te paditurën qe te beje kompensimin e pagës për muajin gusht 2021.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104€, në emër të taksës gjyqësore për padi shumën prej 21€.

E paditura, me anë të përgjigjes në padi nuk ka kontestuar se paditësi është në marrëdhënie pune te e paditura por e ka kontestuar kërkesëpadinë e tij duke theksuar se i njëjti është paguar për punën e kryer gjë qe nuk kontestohet as nga ana e paditësit ne padi, po kontestuese ne ketë rast

mbetet e drejta e pretenduar nga ana e tani paditësit lidhur me kompensimin e një page sa i për këtë muajt Gusht konkretisht prej dt.01.08.2021 deri me datën 31.08.2021, mbi këtë gjendje konsiderojnë se veprimet administrative brenda kompetencave të saj kanë vërtetuar gjendjen faktike nga del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit dhe se pretendimet e paditësit janë nën ndikimin e vërtetimit e një gjendje tjetër faktike, andaj i ka propozuar gjykatës që të refuzoj padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit.

Provat dhe gjendja faktike

Gjykata ka shqyrtuar provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës: Kërkesa për kompensimin e pagës drejtuar Drejtorisë së Arsimit në Glllogoc me nr... e datës 01.09.2021, Aktvendimin e Drejtorisë së Arsimit në Glllogoc i datës 07.09.2021 me nr..., Ankesa e datës 10.09.2021 me nr..., Vendimin e datës.20.09.2021 me nr..., Kontratën e Punës për Mësimdhënës e datës 29.01.2021 me nr....

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, mbështetur në dispozitat nga Neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye si në vijim.

Për gjykatën nuk ishte kontestuese fakti se paditësi ka qenë i punësuar tek e paditura si mësimdhënës i matematikës në SHM “Gj.K. S...”, me pagë mujore neto prej 541.55 €, ky fakt vërtetohet në bazë të kontratës së punës e datës 29.01.2021 me nr... e lidhur në mes palëve ndërgjyqëse.

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi sipas kontratës së lartëcekur kishte punuar tek e paditura edhe për periudhën kohore nga data 01.08.2021 e deri me datë 31.08.2021 me detyra si Mësimdhënës i Matematikës, e po ashtu ky fakt vërtetohet nga deklarimi i të paditurës në përgjigje në Padi.

Nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka paraqitur kërkesë me nr... e datën 01.09.2021 paraprakisht pranë të paditurës për realizimin e drejtës në pagë, mirëpo kjo i është refuzuar në bazë të Aktvendimit të Drejtorisë së Arsimit në Glllogoc i datës 07.09.2021 me nr..., e me pastaj paditësi ka bërë ankesë ndaj këtij Aktvendimi mirëpo Komisioni për ankesa i Komunës së Glllogocit e ka refuzuar duke lënë në fuqi Aktvendimin e datës 07.09.2021.

Faktet kontestuese:

Si kontestues në mes palëve ndërgjyqëse ishte fakti se a i takon kompensimi paditësit si në kërkesëpadi.

Paditësi pretendon se edhe për kundër faktit që i ka kryer obligimet gjegjësisht detyrat e punës si mësimdhënës për periudhën kohore 01.08.2021-31.08.2021, andaj e paditura konform dispozitave ligjore ka obligim kompensimin e pagës.

E paditura e konteston kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se mësimdhënësi ju ka kompensuar pushimi vjetor deri me datën 31.07.2021 duke u mbështetur në Nenin 36 pika 1 e Ligjit të Punës.

Baza juridike dhe vlerësimet e gjykatës

Gjykata vlerësoj se vendosja e kësaj çështje juridike kontestuese si në dispozitiv të aktgjykimit sa i përket aprovimit të padisë se paditëses për mos përmbushjes së kontratës, gjen mbështetje ligjore në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), dhe në dispozitat e Ligjit të Punës.

Kontrata e punës është në harmoni të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës përkatësisht dispozitat nga Neni 11 i po të njëjtit ligj ku parashihet përmbajtja e kontratës së punës. Ndërsa pika 1.11 e cila thotë citoi kontrata e punës duhet të përmbaj edhe “lartësinë e pagës bazë, si dhe ndonjë shtesë ose të ardhura tjera”, e në rastin konkret Neni 2 i kontratës së lidhur në mes palëve kanë përcaktuar pagën bazë për punën të cilën e kryen.

Është rregull e përgjithshme edhe parimi i së drejtës, se palët me vullnetin e tyre të lirë e të shprehur mund të krijohet raporti juridik gjegjësisht marrëdhënia juridike, si dhe po ashtu me këtë vullnet mund të ndryshojnë marrëdhëniet juridike, pasi që kontrata është ligj për palët, andaj duke u mbështetur në këtë parim palët kontraktuese marrin për obligim që të i përmbushin obligimet e tyre kontraktuese ashtu siç figurojnë në kontratë, apo ta ndryshojnë atë me ndonjë kontratë të mëvonshme.

Neni 322 paragrafi 1 i LPK-së, përcakton se: *“Në qoftë se gjykata në bazë të provave të marra (neni 8 i këtij ligji) nuk mund të konstatojë me siguri ndonjë fakt, për ekzistimin e faktit do të përfundojë duke i aplikuar rregullat mbi barrën e provës”*, ndërsa me paragrafin 2 të ligjit dhe nenit të njëjtë përcaktohet se *“Pala që pretendon se i takon një e drejtë ka për detyrë të provojë faktin që është qenësor për krijimin ose realizimin e saj, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër”*.

Andaj obligimi për përmbushjen e kontratës nga ana e palës së paditur rrjedh duke u bazuar me Nenin 8 të LMD-se ku parashihet se pjesëmarrësit e marrëdhënieve të detyrimit kanë për detyrë ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen thotë se detyrimi mund të shuhet vetëm me pajtimin e vullneteve në marrëdhëniet e detyrimit ose në bazë të ligjit.

Palët kontraktuese kanë për obligim që duke u bazuar në ndershmërinë dhe ndërgjegjshmërinë të i përmbushin obligimet kontraktuale, ndaj njëra tjetrës.

Në rastin konkret pala e paditur nuk i ka respektuar këto obligime dhe nuk ka vepruar në ndershmëri dhe ndërgjegjshmëri pasi që edhe për kundër faktit se paditësja i ka kryer detyrat e punës që kanë rrjedh nga kontrata gjegjësisht e njëjti e ka përmbushur kontratën, ku ky fakt vërtetohet nga refuzimi i te paditurës i kërkesës së paditësit me Aktvendimin e dt.07.09.2021 me nr..., ku konstatohet se kërkesa e paditësit lidhur me kompensimin e pagës për periudhën prej datën 01.08.2021 deri me datën 31.08.2021 i është kompensuar me pushim vjetor.

E paditura e ka konteston kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se mësimdhënësi ju ka kompensuar pushimi vjetor deri me datën 31.07.2021 duke u mbështetur në Nenin 36 pika 1 e Ligjit të Punës, mirëpo gjykatës nuk i ka ofruar asnjë provë me të cilën do të bënte të besueshme një pretendim të tillë. Ky përfundim mbështetet edhe në Nenin 7 i LPK-së që përcakton se: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*, dhe në Nenin 319 par. 1 të LPK-së që përcakton se *“Secila nga palët ndërgjygjëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Andaj, gjykata duke u mbështetur në rregullat e lartëcekura, e duke u mbështetur në faktin se palët kanë lidhur kontratë në kohë të caktuar dhe rrjedhimisht kanë detyrime në kohe të caktuar aq sa zgjat kontrata të ju përmbahen kushteve të përcaktuara në kontratë e të cilat kushte janë reciproke, mbi këtë bazë gjykata e aprovoj padinë e paditëses si të bazuar dhe vendosi si në të dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e detyruar të paditurën, që paditësit t’ia paguaj pagën e papaguar për periudhën kohore 01.08.2021 e deri me 31.08.2021 në shumën prej 541.55 €.

Se e paditura i obligohet paditëses si në dispozitiv të aktgjykimit këtë fakt gjykata e mbështetë në Nenin 245 paragrafi 1 të LMD-së i cili nen parasheh se “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se “*Kur debitori nuk e përmbush detyrimin ose vonohet me përmbushjen e tij, kreditori ka të drejtë të kërkojë edhe shpërblimin e dëmit që ka pësuar për këtë shkak*”.

Kamata ligjore është vendosur në kuptim të dispozitave të Nenit 382 të LMD-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të Nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, sipas të cilit pala e cila e humb kontestin tërësisht ka për detyrë që, palës kundërshtare, t’ia kompensojë shpenzimet gjyqësore dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumën prej 104 €, në emër të taksës për padi shumën prej 21 €.

Andaj, bazuar në arsyet e cekura më lartë, e duke u bazuar në Nenin 143 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA GLLOGOC
Departamenti i Përgjithshëm, C. nr. 986/2021, datë 30.01.2024

Gjyqtari
Astrit Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit të tij pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate.